

Mois KAMBERI
Universiteti “Aleksandër Mojsiu”
Durrës, SHQIPËRI
moiskamberi@yahoo.com

UNIFIKIMI I PROGRAMEVE E TEKSTEVE UNIVERSITARE TE
HISTORISE NE TREVAT SHQIPFOLESE
THE UNIFICATION OF THE UNIVERSITY PROGRAMS AND
TEXTBOOKS OF THE HISTORY COURSE IN THE ALBANIAN
SPEAKING TERRITORIES

Hyrje

Programet dhe tekstet e historisë, botimet e ndryshme historike, kanë qenë objekt i diskutimeve, debateve e trajtimeve të shumta nga autorë vendas dhe të huaj pas viteve 90-të. Nga mënyra se si janë trajtuar këto programe e tekste, nuk është arritur në ndonjë rezultat për të konkretizuar unifikimin e programeve e teksteve të historisë në universitetet shqipfolëse publike dhe private. Prandaj dhe ky studim synon të nxisë sa do pak ndërmarrjen e hapave të njëpasnjëshme për unifikimin e programeve e teksteve të historisë në trevat shqipfolëse.

Zhvillimet politike dhe sociale në vitet 90-të në Shqipëri, krijuan mundësi të reja për ndryshime të thella në kurrikulat¹ universitare që duheshin menaxhuar drejtë për të realizuar arritje më produktive në tërë

¹ *Kurrikul*, - term që e ka prejardhjen nga latinishtja, që do të thotë ecuri, vrapim drejt objektit. Kurrikula përkufizohet si një plan që përfshin strategjitë për të arritur objektivat e dëshiruara. Program i kurrikulës përmbledh në vetvete një sistem të tërë njohurish e praktikash të planifikimit e programimit të të mësuarit. Hartimi i kurrikulës është mënyra e konceptimit të lëndës, përmbajtjes, metodave, bazës mësimore e didaktike, përvojave dhe veprimtarive të pedagogëve e studentëve, për të pasur qartësi në zhvillimin e kurrikulës.

hallkat e procesit mësimor në Universitete. Për shkollat e larta, shtrohet problemi për njohje e zbatim të kartës së Bolonjës, të reflektuar në strukturat e fakulteteve, të departamenteve, nisur nga kërkesat e kartës së Bolonjës, duke ruajtur specifikat e vendit, ashtu dhe ato bashkëkohore, që çojnë në lëvizjen e lirë të studentëve, ekuvajlentimin dhe njohjen e lëndëve dhe diplomave tona në Europë, Amerikë, e kudo në botë dhe ndërsjelltazi. (Kraja 2009: 64).

Hartimi i programeve e teksteve të reja duhet të reflektonte me sukses rekomandimet e shtruara nga institucionet ndërkombëtare. Këto institucione kanë qenë shumë të interesuara në realizimin e dy ideve themelore në trajtimin e historisë për vendet e Evropës Juglindore, të përmbledhura në të ashtëquajturat “çarmatim të historisë” dhe të “historisë pa kufij”. Kjo e fundit është në kuptimin e integritit me botën multikulturore, në mbështetjen e vlerave demokratike, në përgjegjshmërinë qytetare, në tolerancën e kundërvënien ndaj qëndrimeve të ngushta, shoviniste etnike, fetare, intolerance, antihumane e antidemokratike. (ISP 2003, nr. 4: 28).

Në këtë kuadër të zhvillimit dhe thellimit të reformës arsimore universitare pas viteve 90-të, të autonomisë së universiteteve, si kudo në Universitetet shqipfolëse publike e private, edhe në Fakultetet e Historisë e në departamentet e saj ndodhën ndryshime të ndjeshme në tërë sistemin e punës për:

- ndryshimet e programeve e teksteve të historisë;
- profilizimet dhe specialitetet në fushën e historisë;
- trajnimin e kualifikimin e stafit akademik ,
- krijimin e qendrave trajnuese e kualifikuese për pedagogët,
- organizimin e simpoziumeve e konferencave shkencore,
- lidhjet dhe marrëdhëniet ne fakultete simotra(binjakzime),
- krijim të hapsirave për eksperiencia profesionale për pedagogët dhe studentët.(Arkiv 2009).

Pavarësisht ndryshimeve që ndodhën në trevat shqipfolëse, të autonomisë së Universiteteve, të ndryshimeve në kurrikulat e sistemit universitar, të programeve dhe teksteve të mbështetura në këto kurrikula, mendoj se pas kaq vitesh punë akademike në fakultetet e departamentet e historisë është e domosdoshme unifikimi i programeve dhe teksteve të historisë në të gjithë sistemin universitar të trevave shqipfolëse, në mënyrë që të hiqen barrierat që pengojnë lëvizjen e lirë të studentëve e pedagogëve nga njëri fakultet në tjetrin, eksperiencia të cilat Europa i kaluar që në shekujt e mesjetës.

1. Programet dhe tekstet e historisë para viteve të 90-ta

Programet dhe tekstet e historisë kishin si synim paisjen e brezit të ri me dije të nivelit bashkëkohor, rritjen më tej të saktësisë shkencore dhe trajtimin e problemeve themelore të zhvillimit historik. Ndërtimi i këtyre programeve e teksteve ishte bërë në bazë të kriterëve të shëndosha ideologjike, shkencore e pedagogjke. Kriteri themelor ideologjik i ndërtimit të programit e tekstit të historisë ishte përshkrimi i përmbajtjes së tyre nga boshti ideologjik marksist Leninist. Filozofia marksiste-leniniste ishte baza teorike e metodologjike e programeve

Po të bësh një analizë të këtyre programeve e testeve arrijmë në këto përfundime:

- programet e historisë ishin dokument bazë për të gjithë fakultetet e katedrat e histori-gjeografisë,
- programet e historisë përcaktonin vëllimin dhe renditjen e materialit, kohën e domosdoshme për studimin dhe shtrirjen e tij sipas viteve të studimit.
- Programet dhe tekstet e historisë ishin të pacënueshme dhe të pandryshueshme,
- Programet e tekste ishin tejet të politizuara në shërbim të partisë shtet (ideologjia bazë ishte marksizëm – leninizmi dhe mësimet e shokut Enver Hoxha).
- Programet pajisnin brezin e ri me dije të nivelit bashkëkohor dhe rritnin më tej saktësinë shkencore. (ISP 1987: 44).
- Këto programe e tekste nuk ishin të unifikuara dhe nuk përdorshin njësoj në gjitha fakultetet e institutet e histori-gjeografisë.

Programet dhe tekstet e historisë gjatë sistemit komunist kanë ndryshuar disa herë fillozofinë dhe përmbajtjen e tyre. Ndryshimet e programeve e teksteve ishin të lidhura me orientimet e partisë-shtet dhe jo me ndryshimet bashkëkohore shkencore. Në Fakultetin e Histori-Filologjisë në UT, Institutin e Shkodrës, Gjirokastrës, etj, ndryshimi i përdorimit dhe zbatimit të programeve e teksteve qëndronte në kohë zgjatjen e studimeve (tre dhe dy vjet), në shtrirjen e tyre vjetore ose simestrale, në dhënien e plota të informacionitshkencor dhe burimeve historike dhe në profesionalizmin që kishin pedagogët e këtyre fakulteteve ku ndjehej dhe përzgjedhja e tyre. Dispencat dhe tekstet e historisë hartoheshin nga Akademik ose profesor profesionist të mësimdhënies në Universitetin e Tiranës dhe ishin materiali kryesor përdorues për të gjithë studentët krahas dhe literaturës shkencore në përdorim ku vendin kryesor e zinin veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit. Në bazë të këtyre programeve

e teksteve qëndronin krahas njohurive shkencore dhe përmbajta ideologjike, ku filozofia marksiste-leniniste ishte baza teorike e metodologjike e programeve e teksteve të reja. Megjithatë, në programet e reja të historisë së kësaj periudhe, vihej re përpjekja për të ndërtuar programe mbi baza shkencore, në themel të tyre qëndronte arritja më e madhe e shkencës historike, por dhe politizimi i tyre. (ISP 2003: 175).

Në vitet 80-të (pas viti 1982) në Fakultetin e Histori-Filologjisë të UT, ndodhi për herë të parë ndarja e profileve që synonin përgatitjen e historianëve e gjeografëve të rinj. (Arkiv 2012). Ndryshuan përsëri programet e teksteve të historisë. U thellua dhe më shumë diferenca e përgatitjes së studentëve të specializuar të Fakultetit të Histori-Filologjisë të Tiranës me ato të Institutive në rrethe. Kalimi i profesoratit dhe akademikeve nga njëri fakultet në tjetrin ishte shumë i vështirë jo vetëm brenda Shqipërisë por sidomos jashtë trevave të shtetit shqiptar. Vetë profilizimi thelloi diferencimin midis fakulteteve të historisë, të programeve, të teksteve dhe unifikimi i tyre as që mund të mendohej. Profilizimi bëri edhe më të pamundur kalimin dhe lëvizjen e studentëve dhe pedagogëve nga njëri fakultet në tjetrin. Kjo lëvizje pengohej jo vetëm nga unifikimi i programit por dhe politikat e partisë shtet.

Profilizimi i degës së historisë i hapi rrugën përgatitjes së historianëve dhe mësuesve të mirfilltë të historisë. Për hartimin e këtyre programeve e teksteve të historisë u angazhuan akademik, profesor, pedagog, punonjës shkencorë, metodistë dhe specialistë të fushës së historisë, të cilët u bënë dhe pjesë e mësimdhënies në fakultetin përkatës. Për herë të parë studentët e kësaj periudhë u filluan të përballen më njohje dhe interpretime të reja shkencore për ngjarje të ndryshme historike kombëtare dhe botërore. Por pavarësisht të rejave që u futën në këto fakultete, në programet dhe tekset e reja të historisë informacionit të ri shkencorë, iu shtua një literaturë të gjerë shkencore, ku natyrisht vendin kryesor e zinin veprat e klasikëve të marksizëm leninizmit dhe Enver Hoxhës (Gani 1987: 45).

2. Programet dhe tekset e historisë pas viteve të 90-ta

Pragu i viteve '90 u shoqërua me një krizë të thellë të brendëshme, që bëhej gjithnjë e më e pranishme në jetën ekonomike politike e shoqërore. Pas rrëzimit të Murit të Berlinit, të cilat lëkundën fort konceptet dhe praktikatat politike, ideologjike, shoqërore të asaj periudhë të rënduar nga diktatura dhe dogmatizmi, që kërkonin ndryshimin e sistemit u kërkuar dhe ndryshime në sistemin arsimor. Në universitete politizimet e tejskajshme filluan të liberalizohen e të zbuten disi, si dhe dogmat e theksuara ideologjike, përfshirë dhe ato që kishin penetruar gjerësisht edhe në jetën e shkollës, por me një ngadalësi të theksuar, të padurueshme.

Me shpejtësi të jashtëzakonshme u rrit lëvizja e protestës, që filloi me karakter ekonomik dhe u shndërua shpejt në lëvizje me karakter të drejtë politik. Qindra akademikë, profesorë, pedagogë e mësues në mbarë vendin u vunë përkrahë studentëve e popullit, duke u shkrirë mes tyre, përmbysën diktaturën dhe vendosën një rend të ri demokratik. Përmbysja e këtij sistemi komunist, treguan se në Shqipëri nuk mund të ecej më me filozofinë marksiste-leniniste dhe se filozofia e saj, që udhëhiqte tërë jetën e vendit, përfshirë dhe arsimin e sidomos sitemin universitar (për përgatitjen e bijëve të denjë për partinë) kishte dështuar. Kërkohej një vizion i ri në ndërtimin jo vetëm të shtetit të ri shqiptar por dhe të kurrikulave universitare, të programeve dhe teksteve të universiteteve, e sidomos atyre që kishin trajtuar një histori tejet të politizuar. Hartimet e programeve e teksteve të reja për lëndën e historisë, përbënin një ndihmesë konkrete për pedagogët e rinj të kësaj lënde, të cilët në shumicën e rasteve, nuk kishin përgatitjen ne duhur. Veprimtari kryesore duhej të ishte përgatitja, miratimi dhe programimi i teksteve të përmirësuara të historisë jashtë çdo ideologjizimi, politizimi, me informacionin e ri bashkëkohor, për të cilat universitetet dhe mësuesit e historisë kishin nevojë shumë të ngutshme.

Periudha e tranzicionit paraqitet me plot shanse, por edhe me paradokse, që shpesh janë shoqëruar me tensione që vijnë sa nga ndeshja e koncepteve dhe praktikave konservatore të trashëguara, me prirjet dhe forcat e reja që kërkojnë ndryshime në programet e tekstet e historisë së Shqipërisë dhe asaj botërore.

Mbi bazën e kësaj platforme, kurríkula e historisë pësoi ndryshime në disa drejtime si:

- në planin strukturor,
- në përmbajtje,
- në planin akademik përmbajtja kurríkurale u pasurua me përmbajtje të reja historike të pa trajtuara deri në vitet 90-të,
- në rafshin shkencor apo pedagogjik e didaktik (Arkiv 1993).

Ndryshimet e thella në organizimin e sistemit arsimor në Shqipëri, u kthyen në qendra debatesh, në UT e Institutet e larta në disa rrethe si Shkodra, Elbasani, Gjirokastra, Korça dhe Vlora, për përmirësimin e strukturave të tyre. Shumë shpejt ata u kthyen nga Institute në Universitete (Arkiv i MASH 1994: 23) u fitua autonomia e tyre, u hapën Universitete private etj. Në Shqipëri krahas universiteteve publike filluan të hapen dhe universitete private sipas nevojave dhe kërkesave që kishte tregu. Universitetet fituan autonominë dhe filluan riorganizimet e tyre të reja jo vetëm në strukturë por dhe në programet e tyre të studimit për të qënë sa më afër kërkesave të tregut të punës dhe jetës së përditëshme. U pa si domosdoshmëri ndryshimet e kurrikulave të historisë në fakultetet përkatëse, të

cilat duhej të zhvisheshin nga manipulimet dhe të trajtoheshin me objektivitetin e duhur shkencor.

Programet ekzistuese nuk u përgjigjeshin kërkesave të reja të kohës si nga ana didaktike ashtu dhe nga brendia e tyre mësimore. U pa e nevojshme që për këto ndryshime dhe përmirësime të programeve dhe teksteve të historisë të kërkohej ndihma e profesorëve e specialistëve të huaj nga vendet evropianoperëndimore.

Miratimi i programeve të reja të historisë nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, janë dokumentat bazë në punën e Fakulteteve e departamenteve të historisë, sepse në bazë të tij përcaktohet vëllimi dhe rënditja e materialit, koha e domosdoshme për studimin e këtij sipas viteve të studimit. Në këto vite për ngritjen e mëtejshme cilësore të punës në shkencën historike, u kërkohej akademikëve dhe profesorëve të historisë, studiuesve shkencorë që programet e reja të historisë të pajisin brezin e ri studentor me dije të nivelit bashkëkohor, të rritin më tej saktësinë shkencore të argumentave dhe të trajtonin më thellë problemet themelore të zhvillimit historik. Programet e Historisë duhej të pasqyronin një vargëzim logjik konceptesh, ligjësi dhe dukuri historike nga kursi në kurs (Gani 1987: 44).

Trajtimi i ri i përmbajtjes së historisë ka sjellë edhe përmirësimin e programeve të saj. Programet e tekstet e historisë u përpunuan e u ndërtuan mbi kritere më të shëndosha shkencore e pedagogjike. Ata përmbanin material konkret, fakte ngjarje, dukuri si dhe sqarime dhe interpretime të mbështetura në kritere të drejta shkencore dhe të argumentuara nga një literaturë e gjerë shkencore. Në programet dhe tekstet e historisë, duke u ndalur në ngjarjet, dukuritë dhe veçoritë tipike të shteteve më kryesore dhe asaj kombëtare synohej të realizohej lidhja organike e historisë së vendeve të ndryshme në periudhat dhe etapat përkatëse, për të nxjerrë tiparet e përbashkëta të këtyre ngjarjeve, për të kaluar në disa përgjithësime, shumë prej të cilave janë aktuale dhe sot.

Mbi bazën e kësaj platforme, kurrikula e degës së historisë pësoi ndryshime në disa drejtime:

Në planin strukturor dhe në përmbajtje. Brenda saj u krijuan tri profile apo specialitete shumë të domosdoshme në përshtatje me nevojat që shtronte koha: i historisë, arkeologjisë dhe i mësuësishë (ISP 2003, nr. 4: 198). Ky ishte një ndryshim jo i vogël e lehtë për t'u realizuar, por i domosdoshëm, ishte rrjedhojë e reflektimit për detyrat e shtruara nga organet e larta shtetërore për shkollat e larta, për krijimin e strukturave kurrikulare të reja me profilizime të ngushta, në përshtatje me nevojat që shtronte koha. Ky mendim dhe iniciativë për krijimin e tyre u kristalizua në konsulentat dhe diskutimet e shumta me specialist të vendit dhe të huaj (ISP 2003, nr. 4: 198).

Në planin akademik përmbajtja kurrikulare u pasurua me përmbajtje të reja historike të patrajuara deri në këto vite. U pasurua me lëndë të tilla, si: historia e qytetërimeve, historia e kulturës, historia e feve, historia e mendimit historik, metodologji e historisë, integrimi evropian, civilizimet joeuropiane etj. Futja e lëndëve të reja, ndryshuan raportet në planet e programet mësimore, duke bërë rivlersime të lëndëve mbi bazën e rëndësinë e tyre. Janë bërë ndarje të lëndëve të rënduara duke titulluar lëndë të reja dhe duke i shtrirë ato si simestrale, është zgjeruar sistemi i lëndëve më zgjedhje, kurset speciale, janë shtuar vëprimtaritë mësimore praktike, si seminare apo detyra kursi etj. Por duhet theksuar që këto programe të reja që janë futur në fakultetet e historisë në këto vitë, por janë të kahershme per fakultetet perëndimore (ISP 2000, nr. 4: 198).

Në stadin aktual, në kuadrin e zbatimit e thellimit të reformës arsimore, krahas hapave pozitive të hedhura në këtë drejtim, ndeshemi dhe me problem e detyra që duhen kapërcyer. Ne jemi të ndërgjegjshëm se duhet të thellojmë më tej frytshmërinë e punës për organizimin e modeleve trajnuese brenda fakultetit me stafin e pedagogëve që merren me trajtimin shkencor, sidomos atë didaktik. Pedagogët kanë nevojë për një trajtim didaktik në shërbim të mësimdhënies në universitete. Mësimdhënia e shumë pedagogëve lë për të dëshiruar sepse, akoma në një masë të madhe, aplikohet leksioni tradicional. Të paktë janë pedagogët që kanë bërë ndryshime në mësimdhënie duke trajtuar përmbajtjen lëndore në mënyrë bashkëkohore, me zhdërvjelltësi dhe me pjesëmarrjen edhe të studentëve, të literaturës plotësuese, të materialeve didaktike, të projektorit, dhe me përdorim të gjerë të diskutimit, etj. Shumë pedagogë të përfshirë në projektë të ndryshme, tani kanë marë kualifikimin ose përmbajtjen shkencore të lëndës për metodologji të mësimdhënies në universitete.

Me gjithë arritjet e kohëve të fundit në fushën e botimeve, akoma ka mungesa në tekstet që duhet të përdorin studentet duke lejuar edhe mendimet alternative. Duhet theksuar që në botimet e teksteve universitare janë bërë hapa të rëndësishëm. Janë bërë përmirësime në rritjen cilësore të teksteve përsa i përket përmbajtjes shkencore e didaktike. Shumë autorë në hartimin e këtyre teksteve janë pedagogë me tituj shkencorë, që është pozitive për ndihmesën që japin ata në realizimin e përmbajtjes së tyre shkencore.

Në këtë moment historik, nisur nga fakti se jetojmë e punojmë në kohën kur kanë ndodhur një bum në fushën e teknikës e kibernetikës, ku janë afishuar metoda e teknologji të shumta bashkëkohore në sistemin e arsimit e të edukimit, kur njohuritë e dijet historike shumohen me përmasat e mëdha, para mësimdhënies së historisë për trajnimin shkencor e profesional të gjeneratave të studentëve, kërkohen të krijohen e të zbatohen standarte të një niveli të lartë shkencor e didaktik, që t'u përgjigjen

kërkesave afatmesme e afatgjata të programeve e teksteve të historisë, të reformës arsimore që zhvillohen në vendin tonë, për të krijuar lehtësira të lëvizjes së lirë të pedagogëve e studentëve në universitetet shqipfolëse nëpërmjet marrëveshjeve ndërqeveritare e ministrorë. Kjo është shumë e lehtë të realizohet në qoftë se ne unifikojmë programet e tekstet në këto treva, që eliminojnë pengesat burokratike të lëvizjes dhe njohjes së programeve të studimit e diplomave në fakultetet dhe vendet përkatëse.

Këtë unifikim Europa e kishte kuptuar dhjetëra shekuj më parë si një element shumë të rëndësishëm të civilizimit të shoqërisë. Europeanët që në Shek. XII e kuptuan se dija duhej të kalonte nga dyert e manastireve në qytete, aty u hapën shkolla laike e universitete si: i Bolonjës, Padovës, Pizës, Peruxhias, Parisit, Montpeliesë, Oksfordit, Kembrixhit etj. Këto universitete europiane që unifikimi i përdorimit të gjuhës, programeve, teksteve do të lejonte lëvizjen e lirë të pedagogëve e studentëve nga njëri universitet në tjetrin, duke formuar kështu një kulturë të gjerë dhe unike që qëndronte mbi kulturat e veçanta të popujve të ndryshëm. Këtë unifikim kërkojmë të arrijmë dhe ne sot në të gjitha universitetet shqipfolëse e sidomos ato të historisë.

Përfundim

Që të realizojmë këtë unifikim, që europeanët e arritën shumë shekuj më parë, në përdorimin e gjuhës, programeve e teksteve, lëvizjen e lirë të studentëve e pedagogëve nga njëri universitet në tjetrin, ne kërkojmë ta realizojmë sot e në vazhdim:

- me angazhimin ndërqeveritar e ministrorë në trevat shqipfolëse,
- me angazhimin mbarë kombëtar të burimeve njerëzore: akademik, profesor, punonjës shkencor, metodistë etj.) të specializuara në fushën e didaktikës e shkencës histories, të sukseshëm në hartimin e programeve e teksteve,
- Me angazhimin e shoqatave të historianëve shqiptarë, që kanë një listë të gjatë burimesh historike brenda dhe jashtë vendit,
- me angazhimin dhe bashkëpunimin ndërmjet fakulteteve e departamenteve të historisë në trevat shqipfolëse,
- me bashkëpunimin me ekspertë të huaj, trajnime brenda dhe jashtë vendit për arritjet bashkëkohore dhe në kërkimin shkencor,
- me angazhimin, bashkëpunimin dhe binjakëzimin me fakultete të të njëjtit profil europianoperëndimorë etj.

Bibliografi

- ARKIV i MASH, (1994), Fodi 21, d. 10, f. 23.
- ARKIV, (1993) Universiteti I Tiranës, Fakulteti i Histori –Fillologjisë, Tiranë).
- ARKIV, (2009) Universiteti I Tiranës, Fakulteti i Histori –Fillologjisë, Tiranë).
- ARKIV, (2012) Universiteti I Tiranës, Fakulteti i Histori –Fillologjisë, Tiranë).
- FILO, Ll. (2003), *Tekstet e reja të historisë dhe kërkesat e shoqërisë modern të integruar*, Tiranë.
- ISP (2003), “*Kurrikula dhe shkolla, histori-gjeografi*”, nr. 4, Tiranë.
- KRAJA M. (2009), *Pedagogjia*, Mirgeralb, Tiranë.
- KRAJA M. (2008), *Pedagogjia*, Geer, Tiranë.
- ISP (2003), “*Kurrikula dhe shkolla, histori-gjeografi*”, nr. 4, Tiranë.
- GANI. A., FILO, Ll., TASELLARI. M., DËRGUTI.M., THËNGJILLI.P., KURI V. (1987), “*Metodika e Historisë*”, SHBLSH, Tiranë.
- XHELILI. Q., SULA I. (2003), “*Trajtimi fillestar i mësuesve të historisë*”, Kurikula dhe shkolla, Tiranë.

Përmbledhje

Sot është shumë më i rëndësishëm se kurrë unifikimi dhe reformimi i programeve e teksteve të historisë në përmbajtje, ndërkohë që në trevat shqipfolëse po kalojnë tranzicionin, me qëllim për ta bërë arsimimin e të rinjve sa më formues e sa më të efekshëm. Për këtë duhet që trajtimi i historisë të jetë i afërt në të gjitha trevat shqipfolëse e në përputhje me kërkesat për formimin e një shoqërie sa më demokratike në përshtatje me kërkesat e organizatave ndërkombëtare. Rritja e interesit që shfaq shoqëria për historinë, me të drejtën për të ndërhyrë në interpretimin e shumë ngjarjeve historike, kërkon jo vetëm unifikimin e programeve e teksteve të historisë, por dhe ngritjen e nivelit shkencor e metodik të pedagogëve, kurrikulave e përmbajtjes së tyre si programe e tekste mbarëkombëtare. Programet e teksteve duhet të jenë jo vetëm të unifikuara, por dhe të vendosin raporte të drejta ndërmjet interpretimeve alternative, mendimit kritik dhe formimit atdhetar e bashkëkohor të brezave. Punimi synon rritjen e bashkëpunimit mbarëkombëtar për hartimin e programeve e teksteve të unifikuara universitare për të gjitha trevat shqipfolëse.

Fjalë çelës: program, unifikim, interpretim, mendim kritik, histori, bashkëkohor.

Summary

Nowadays, there is an urgency for the unification and the reforming of history programs and textbooks in terms of content considering the transitional time that Albanian speaking territories are experiencing with the aim to provide a more formative and efficient education to Albanian speaking youth. Endeavoring to achieve this, the way the history is treated should converge in all the Albanian speaking territories in compliance with the demand for the creation of a democratic society as specified and welcomed by the international organizations. The increase in the society's interest shown towards the historical developments in the course of time closely associated with their right to provide their interpretations of the historical events demands for the unification of the history programs and textbooks, as well as an increased scientific and methodological level of the preparation of the teachers and an increased scientific and methodological level of the curricula and textbooks as recognized across the nation. The university programs should undergo unification by paying due respect to and establishing rightful connections and relations with the alternative interpretations, critical thinking and the future patriotic and contemporary formation of the generations to come. The research aims at promoting and establishing nationwide cooperation for designing unified university textbooks and programs for all the Albanian speaking territories.

Key-words: program, unification, interpretation, critical thinking, history, contemporary.